| 10 | 1506/4 | "Vite lufte cikël,1973" Pushim partizan | 24 x 30,5 | Letër / Gjilpërë e thatë | 20.000 | 5469 |
| 11 | 1527 | Portret vajze,1965 | 43.7 x 57 | Vaj / Kanavacë | 150.000 | 3418 |
| 12 | 1709 | Portret i Mao Ce Dunit,1975 | 115x119 | Vaj / Kanavacë | 150.000 | 5479 |
| 13 | 1738 | Portret i Shokut Enver Hoxha,1974 | 119.5 x 114.5 | Vaj / Kanavacë e plotë | 200.000 | 5491 |
| 14 | 1980 | Shkrimtari Shefqet Musaraj,1976 | 90 x 100.2 | Vaj / Kanavacë | 150.000 | 5475 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | 2064 | Kuvendi I Lezhës,1978 | 183 x 123 | Vaj / Kanavacë | 100.000 | 5484 |
| 16 | 2068 | Pashko Vasa,1978 | 90 x 100 | Vaj / Kanavacë | 150.000 | 5482 |
| 17 | 2310 | Natyre e qete me lahutë e çifteli ,1978 | 50 x 70 | Vaj / Fajazit | 100.000 | 5486 |
| 18 | 2451 | Malësorja e vogel ,1975 | 50 x 41 | Vaj / Kanavacë | 150.000 | 5477 |
| 19 | 2553 | Hidrocentrali i Fierzës, 1979 | 69 x 50 | Vaj / Fajazit | 100.000 | 5478 |
| 20 | 2554 | Pejzazh , 1982 | 42.4 x 50 | Vaj / Fajazit | 100.000 | 5481 |
| 21 | 3125 | Kallmetorja | 45.5 x 56 | Vaj / Kanavacë e plotë | 100.000 | 5474 |
| 22 | 4527 | Ded Gjon Luli në Deçiç,1963 | 102 x 151 | Vaj / Kanavacë | 300.000 | 71918 |

**VENDIM**
**Nr. 237, datë 21.3.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA E KATËRT, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ, MBYET, PATOS–FSHAT", FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike, faza e katërt, njësia administrative Portëz, Mbyet, Patos–Fshat", Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë, sipërfaqe "tokë truall" dhe "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 7 464 000 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 464 000 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Fier.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN
PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
"ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA IV, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ, MBYET,
PATOS–FSHAT" FIER

| Nr. | Emër mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e përgj. tokë/arë (m²) | Sip. e prekur tokë/arë (m²) | Çmimi për truallin (lekë/m²) | Vlera e truallit (lekë) | Vlera e përgj. (lekë) | Gjendja juridike e pasurisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ibrush Hoxha | 2637 | 288/142 | 3117 | 3117 | 1000 | 3,117,000 | 3,117,000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Mylazim Hoxha | 2637 | 288/117 | 3467 | 3467 | 1000 | 3,467,000 | 3,467,000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 3 | Mynyr Beqiraj | 2891 | 392/31 | 2000 | 2000 | 440 | 880,000 | 880,000 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| | | | | | | | | **7,464,000** | |

**VENDIM**
**Nr. 238, datë 21.3.2017**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS 'XOXI ANDONI' DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", SHTESAT, FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugës 'Xoxi Andoni' dhe hapësirave rreth saj", shtesat, Fier.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe "tokë truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 26 492 996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 26 492 996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VLERËSIME PËRFUNDIMTARE PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTEVE PËR INTERES PUBLIK**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË SHTESË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS 'XOXI ANDONI' DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", FIER

| Nr. | Emër mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e përgj. e truallit (m²) | Sip. e prekur e truallit (m²) | Çmimi për truallin (lekë/ m²) | Vlera e truallit (lekë) | Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m²) | Sip. e prekur e ndërtesës (m²) | Amortizimi (%) | Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë) | Vlera e përgjith. (lekë) | Gjendja juridike e pasurisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Anastas Andon Gjata | 8534 | 3/459 | 234.40 | 24.65 | 12,893 | 317,812 | 229.00 | 17.05 | 5% | 663,110 | 980,922 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 2 | Safet Qenan Troka | 8534 | 3/468 | 50.00 | 50.00 | 12,893 | 644,650 | - | - | - | - | 644,650 | Inskriptuar 2 herë në favor të Luan Toska dhe Bledar Toska |
| 3 | Agron Sulejman Xhafa + bashkëpronarë | 8534 | 3/33 | 1,627.00 | 1627.00 | 12,893 | 20,976,911 | - | - | - | - | 20,976,911 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 4 | Imer Ismahil Osmënaj | 8534 | 3/65 - N2 | - | - | - | - | 43.60 | 43.60 | 20% | 699,138 | 699,138 | Konfirmim nga ZVRPP-ja |
| 5 | Hena Halim Rizaj | 8534 | 3/65 - N5 | 15.90 | 15.90 | 12,893 | 204,999 | 31.80 | 31.80 | 30% | 446,182 | 651,181 | Plotësim dokumentacioni në lidhje me truallin |
| 6 | Flamur Myrdar Kondi | 8534 | 3/290 | 60.00 | 60.00 | 12,893 | 773,580 | 33.00 | 33.00 | 5% | 1,766,614 | 2,540,194 | Inskriptuar në favor të Fondit Besa sh.a. |
| | | | | | | | | | | | **Vlera totale** | **26,492,996** | |

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

## VENDIM
## Nr. 239, datë 21.3.2017

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 343, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS SË TRANSMETIMIT 110 kV, UZNOVË–ÇOROVODË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 343, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, nga lista e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik, hiqet pasuria me numër rendor 29, shtylla 45, numër pasurie 32/16, zona kadastrale 3019, NB Poliçan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## UDHËZIM
## Nr. 9, datë 15.3.2017

### PËR ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2017, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, të jenë:
a) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1): 26 gusht 2017;
b) Matematikë (D2): 29 gusht 2017;
c) Gjuhë e huaj (D3): 1 shtator 2017;
d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2): 6 shtator 2017.

2. Provimet e Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00.

a) Provimet e lëndëve me detyrim të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

b) Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.

3. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, ndërsa 12 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 37 pikë.

4. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, ndërsa 10 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 30 pikë.

5. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje, të hyjnë në provim në orën 11:00 dhe ta përfundojnë atë në orën 13:00.

6. Në provimet e Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2017, sesioni i parë.

b) Maturantët që rezultuan mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2016–2017 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 22 gusht 2017.

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2017, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore.

d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë njësuar dokumentet shkollore nga MAS-i.

7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 6, germat "a" dhe "b", të plotësojnë formularin Al Z për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore.

8. Kandidatët/kandidatët e përcaktuar në pikën 6, germat "c" dhe "d", të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton DAR/ZA-ja e vendbanimit të tyre. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z në datat 21–23 gusht 2017.

9. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, në datën 23 gusht 2017. Drejtori i DAR/ZA-së ta dërgojë këtë listë në AKP në datën 24 gusht 2017.

10. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale. ZA Tropojë, ZA Lushnjë dhe ZA Sarandë t'i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre. ZA Delvinë t'i zhvillojë provimet në qytetin e Sarandës.

11. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë.

12. Drejtori i DAR/ZA-së, brenda datës 20 gusht 2017, të njoftojë zyrtarisht AKP-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë.

13. Në DAR-ët, ku numri i maturantëve /kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

14. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, të bazohet në urdhrin nr. 39, datë 31.1.2017, "Për miratimin e rregullores së Maturës Shtetërore 2017 në Republikën e Shqipërisë".

15. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të vartësisë.

16. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it, në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2017, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

17. Ngarkohen, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Financave, AKP-ja, ISHA-ja, IZHA-ja, APAAL-ja, AKAFPK-ja, njësitë arsimore vendore dhe shkollat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
**Lindita Nikolla**

## URDHËR
## Nr. 19, datë 21.3.2017

## PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integrimit Europian, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Daniela Çekani, për autorizimin e shërbimeve brenda vendit, në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integrimit Europian, do të ushtrohen për periudhën nga data 21.3.2017 deri në datën 31.12.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Europian, znj. Daniela Çekani.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
**Klajda Gjosha**

## KËRKESË
## Nr. 1534, datë 17.3.2017

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga "Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P. në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Durrës" për pasurinë e llojit "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "arë".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është **4 158 575** (**katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë**) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
**Bahri Shaqiri**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
**SEKTORI I SHPRONËSIMEVE**

**Lista e pronarëve që preken nga "Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P. në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Durrës"**

| Nr. | Pronari | | Z.K. | Nr.pas | Lloji i pas. | Sip.totale (m2) | Sip. e shpronësimit (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera totale (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Mbiemri | | | | | | | | |
| 1 | Zihni Besnike Devis Rexhep Klodjan | Dana | 2332 | 527/10 | Arë | 10475 | 10475 | 397 | 4158575 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| | SHUMA TOTALE | | | | | | 10475 | | 4158575 | |

**KËRKESË**
**Nr. 1570, datë 17.3.2017**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, loti III (shtesa)" për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është **455 841 478** (**katërqind e pesëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë**) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
**Bahri Shaqiri**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista pronarëve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "UNAZA LINDORE, LOTI III (shtesa)"

| | | | | Zona | Numri | LLOJI | SIPERFAQA | Sip | Cmimi | | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Atesia | Mbiemri | Kadast | Pasuris | I PASURISE | TOTALE ( m2) | Shpronesimit (m2) | (leke/m2) | Vlera | |
| 1 | B.P KARROCI,DUZA,DAKO,NDROQI,ALUSHI | | | 8180 | 6/713 | TRUALL | 3740.34 | 3452 | 31270 | 107944040 | KONF.ZVRPP |
| 2 | QEMAL | RAMAZAN | DISHA | 8180 | 6/681 | TRUALL | 300 | 241 | 31270 | 7536070 | KONF.ZVRPP NR.27104/5 DT.09.11.2016 |
| 3 | BASHKPRONARE TABAKU,SAMI,CANAJ ETJE | | | 8170 | 7/252 | TRUALL | 1013 | 103 | 32878 | 3386434 | KONF.ZVRPP NR.39287/1 DT 08.02.2016 |
| 4 | ZEGJINE TABAKU,GEZIM TABAKU,SADIK TABAKU | | | 8170 | 7/276 | TRUALL | 2680 | 448 | 32878 | 14729344 | KONF.ZVRPP |
| 5 | B.P TABAKU,ELEZI ETJE | | | 8170 | 7/683 | TRUALL | 2582 | 1946 | 32878 | 63980588 | KONF.ZVRPP NR.39536/1DT23.12.2016 |
| 6 | MUHARREM | | BATHORJA | 8170 | 7/704 | TRUALL | 498.3 | 20 | 32878 | 657560 | KONF.ZVRPP |
| 7 | B.P MANCAKU | | | 8170 | 7/697 | TRUALL | 400 | 34 | 32878 | 1117852 | KONF.ZVRPP |
| 8 | MAJLINDA CELIKU,ANISA CELIKU | | | 8170 | 7/699 | TRUALL | 600 | 383 | 32878 | 12592274 | KONF.ZVRPP |
| 9 | B.P TABAKU | | | 8170 | 7/700 | TRUALL | 745 | 448 | 32878 | 14729344 | KONF.ZVRPP |
| 10 | B.P BEBRI | | | 8170 | 8/665 | TRUALL | 500 | 120 | 32878 | 3945360 | KONF.ZVRPP |
| 11 | SHOQERIA "BAU XONSTRUCTION" | | | 8170 | 9/609 | TRUALL | 24405.5 | 1913 | 32878 | 62895614 | KONF.ZVRPP VENDOSET MASE E SIG TE PADISE GJ.RR.TIRANE NR.5731 DT 15.7.2016 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | HAXHI | MUHARREM | SAUKU | 8170 | 9/558 | TRUALL | 499.8 | 257 | 32878 | 8449646 | KONF.ZVRPP BLLOKIM HIPOTEKE |
| 13 | B.P SAUKU,STERMASI ,DEMNERI DHE ,P. QOSJA,F. BRAHIMI,J. HALILI | | | 8170 | 9/102,9/103 | TRUALL | 10480 | 650 | 32878 | 21370700 | KONF.ZVRPP MBIVENDOSJE PAS NR 9/102 DHE 9/103 PROT. 10039/1 DT09.02.2017 |
| 14 | B.P BALLATI,GEGA,MARA,GECA | | | 8170 | 10/31 | TRUALL | 3798 | 810 | 32878 | 26631180 | KONF.ZVRPP |
| 15 | B.P QEFALIA | | | 8170 | 10/95 | TRUALL | 979 | 475 | 32878 | 15617050 | KONF.ZVRPP |
| 16 | BSHKPRONERET Tabaku | | | 8180 | 6/295 | TRUALL | 6092 | 1290 | 31270 | 40338300 | KONF.ZVRPP PROT. 10039/1 DT.09.02.2017 |
| 17 | SABRI | ISMAIL | OZUNI | 3976 | 234/44 | TRUALL | 510 | 124 | 479 | 59396 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 18 | VERGIM | ZAIM | BODE | 3976 | 233/146 | ARE | 432 | 301 | 448 | 134848 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 19 | ALBERT | SHABAN | SINANI | 3976 | 233/19 | ARE | 750 | 495 | 448 | 221760 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 20 | ILIR | HIDAI | MECE | 3976 | 233/139 | ARE | 374 | 199 | 448 | 89152 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 21 | HIDAI | SALI | MECE | 3976 | 233/140 | ARE | 666 | 634 | 448 | 284032 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 22 | MUHARREM | KALEM | LALA | 3976 | 233/23 | ARE+TRUALL | 2307 | 840 | 448 | 376320 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 23 | B.P GECA,MARA,TJEGULLA | | | 3976 | 230/155 | TRUALL | 2600 | 2600 | 479 | 1245400 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 24 | KOSTANDIN | JORGJI | DODI | 3976 | 230/41 | TRUALL | 325 | 15 | 479 | 7185 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 25 | AL BERT | ZYLFO | PASHA | 8170 | 10/22 | TRUALL | 230 | 201 | 32878 | 6608478 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 26 | SAIMIR | YMER | CEKREZI | 3976 | 184/22 | ARE | 300 | 55 | 448 | 24640 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 27 | GEZIM | SELAMI | COLLAKU | 3976 | 233/106 | ARE | 1200 | 864 | 448 | 387072 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 28 | AQIF | MALIQ | SINANI | 3976 | 231/2 | ARE | 6300 | 1377 | 448 | 616896 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | AQIF | MALIQ | SINANI | 3976 | 231/22 | ARE | 3500 | 1771 | 448 | 793408 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 30 | FATMIR | SHABAN | MARA | 3976 | 230/94 | ARE | 300 | 8 | 448 | 3584 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 31 | AJDIN | PERVAT | SADAJ | 3976 | 230/32/1 | ARE | 260 | 9 | 448 | 4032 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 32 | YMER HOXHA,SANIJE HOXHA | | | 3976 | 230/42 | TRUALL | 230 | 61 | 479 | 29219 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 33 | GAZMEND | SHABAN | SINANI | 3976 | 233/20 | ARE | 400 | 195 | 448 | 87360 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 34 | GJAKOMO | HIQMET | TJEGULLA | 3976 | 231/38 | ARE | 5684 | 3148 | 448 | 1410304 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 35 | SKENDER | HAXHI | REXHA | 8170 | 10/305 | TRUALL | 498 | 20 | 32878 | 657560 | KONF.ZVRPP 27104/4 DT07.10.2016 |
| 36 | B.P QEFALIA (10 PRONARE) | | | 8170 | 10/306 | TRUALL | 1606 | 27 | 32878 | 887706 | KONF.ZVRPP 27104/4 DT07.10.2016 |
| 37 | QIMULI | | DUVLI | 8180 | 6/8 | TRUALL | 160 | 6 | 31270 | 187620 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 38 | HAXHI | | LAMI | 8180 | 6/259 | TRUALL | 255 | 148 | 31270 | 4627960 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 39 | ISMAIL | | SULA | 8180 | 6/218 | TRUALL | 80 | 80 | 31270 | 2501600 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 40 | B.P DERHEMI | | | 8180 | 6/283 | TRUALL | 150 | 12 | 31270 | 375240 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 41 | KRYEGJYSHATA BOTERORE E BEKTASHIVE | | | 8180 | 6/254 | TRUALL | 360 | 28 | 31270 | 875560 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 42 | KRYEGJYSHATA BOTERORE E BEKTASHIVE | | | 8180 | 6/258 | TRUALL | 2037.45 | 136 | 31270 | 4252720 | KONF.ZVRPP 39287/1 DT.08..02.2016 |
| 43 | ERION | MAHMUT | FUSHA | 8180 | 7/597 | TRUALL | 350 | 350 | 31270 | 10944500 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| 44 | FATBARDHA ,FATION (B.P) | | FUSHA | 8180 | 7/646 | TRUALL | 391.9 | 391 | 31270 | 12226570 | NE PROCES KONFIRMIMI DHE SAKTESIMI (SIPAS CERTEFIKATES SE PRONESISE) |
| | | | | | | | | Shuma totale | | 455841478 | |

**KËRKESË**
**Nr. 3699, datë 20.3.2017**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Jashtme shpall kërkesën për shpronësim publik të një pjese të pasurisë së paluajtshme, me adresë lagjja "5 Maji", qyteti i Elbasanit, me të dhëna kadastrale: në pronësi të Shazimar Karaosmani, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 8525-766, datë 3.12.2013, lloji "tokë truall", sipërfaqja 5000 (pesë mijë) $m^2$, me numër pasurie 28/28, volumi 2, faqe 226, zona kadastrale nr. 8525 Elbasan.

Në përputhje me parashikimet e nenit 15/1, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik, i ndryshuar, me anën e kësaj shpalljeje njoftojmë pronarët e truallit dhe personat e tretë të interesuar që preken nga ky shpronësim se:

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Shpronësimit ka vendosur si vijon:

Vlera e truallit objekt shpronësimi për njësi: 14, 192 lekë/$m^2$;

Sipërfaqe trualli objekt shpronësimi: 5000 $m^2$;

Vlera totale e shpronësimit: 70,960,000 (shtatëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Ky njoftim do të publikohet për një periudhë njëjavore. Brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit, pronarët apo personat e interesuar, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për shpronësimet, i ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kërkesat duhet të paraqiten të shoqëruara me dokumentet përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik", i ndryshuar.

ZËVENDËSMINISTRI I
PUNËVE TË JASHTME
**Halil Hyseni**

**KËRKESË**
**Nr. 1901, datë 24.3.2017**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi urban i shesheve të fshatrave Allambrez, Cukalat, Kutalli dhe Poshnje", Ura Vajgurore.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **751,100** (**shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind**) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
**Alferd Dalipi**

Lista e shpronësimeve për projektin "Rehabilitimi urban I shesheve të fshatrave"

| Nr. | Pronar | Përshkrimi | ZK | Nr.pasurisë | Sip.totale m2 | Lloji I pasurisë | | Çmimi njësi | Vlera e shpronësimit | Konfirmuar ZVRPP-ja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | truall | are | | | |
| 1 | Yzedin Shahini | sheshe-lulishte | 1016 | 994/2 | 1300 | | 1000 | 203 | 203000 | po |
| 2 | Lavdosh Zanaj dhe | sheshe-lulishte | 1427 | 169/3 | 2650 | | 1000 | 203 | 203000 | po |
| 3 | Dritan Zanaj | | | | | | | | | po |
| 4 | Lorenc Krimce | sheshe-lulishte | 2349 | 51/17 | 1200 | 300 | | 203 | 60900 | po |
| 5 | Lorenc Krimce | sheshe-lulishte | 2349 | 51/17 | 1200 | | 350 | 203 | 71050 | po |
| 6 | Ilirjan Gllava | sheshe-lulishte | 3032 | 454/43 | 237.5 | 237.5 | | 203 | 48212.5 | po |
| 7 | Shefqet Gllava | sheshe-lulishte | 3032 | 454/44 | 237.5 | 237.5 | | 203 | 48212.5 | po |
| 8 | Islam Gllava | sheshe-lulishte | 3032 | 454/45 | 575 | 575 | | 203 | 116725 | po |
| | | | | | | | | **Totali** | **751100** | |

## KËRKESË
**Nr. 1902, datë 24.3.2017**

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Për ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **156,100** (**njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind**) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
**Alferd Dalipi**

Lista e shpronësimeve për projektin "Ndërtim kopështesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore"

| Nr. | Pronar | Përshkrimi | ZK | Nr. Pasurisë | Sip. Totale m2 | Lloji i | pasurisë | Çmimi Njësi | Vlera e shpronësimit | Konfirmuar ZVRPP-ja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | truall | are | | | |
| 1 | Agron Nazif Lika | Kopësht-ambulancë | 2881 | 475/2 | 250 | 250 | | 213 | 53250 | po |
| 2 | Rrapush Qerim Mile | Ambulancë | 1004 | 1760/9 | 650 | 50 | | 203 | 10150 | po |
| 3 | Xhelal Riza Xhelo | Kopësht | 1093 | 1061/17 | 1400 | 450 | | 206 | 92700 | po |
| | | | | | | | | **Totali** | **156100** | |

## VENDIM
*(i shkurtuar)*
**Nr. 1328, datë 20.3.2017**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1328, datë 23.2.2017, vendosi shpalljen e shtetasit Kalem Gjoka si të zhdukur në datën 31.7.2004, si dhe caktimin e kërkueses Fatime Gjoka si kujdestare të pasurisë së tij.

## KËRKESË

Shtetasit Sonila Bardhi, Valentina Bardhi, Romina Bardhi dhe Irfan Bardhi kërkojnë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të babait të tyre, shtetasit Vahit Ramadan Bardhi nga data 25 nëntor 1995, si dhe caktimin si kujdestare në administrimin e pasurisë së tij kërkuesen Sonila Bardhi.

KËRKUESE
**Sonila Bardhi**

## KËRKESË

Shtetasja Drita Halili e bija e Vathit, e datëlindjes 14.11.1946, lindur në Durrës dhe banuese në SHBA, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të djalit të saj, shtetasit Alban Halili, i biri i Besnikut, lindur më 7.11.1977, në Lushnjë.

KËRKUESE
**Drita Halili**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë